



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-23230/20 datë:26.10.2020



Npi – 01/280 datë: 23.11.2020

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.7 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve 01Nr.06/2005-43, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 23.11.2020, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IX- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 23.11.2020 (e hënë) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.01

Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: z.Rahman Kadrija, znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, z.Ruzhdi Brahimi, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Rahman Kadrija, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më: 30.10.2020,
2. Vizitë në Qendrën për Punë Sociale- Problemet lidhur me Skemat sociale për komunitetin pakicë,
3. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të Punës për KPK-në për vitin 2021,
4. Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve nga mbledhjet më: 30.10.2020

Kryesuesi, z.Rahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 30.10.2020.**

Pika 2

Vizitë në Qendrën për Punë Sociale- Problemet lidhur me Skemat sociale për komunitetin pakicë

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; E njoftoi Komitetin për Komunitete për nevojën për ta bërë një vizitë të tillë, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje për të gjithë, unë mendoj se për shkak të pandemisë ne nuk kemi nevojë me shkuar për vizitë të gjithë anëtarët e Komitetit por vetem një numër i vogël i anëtarëve, me Kryesuesin, ose Muhameti ose Diarta, por që paraprakisht duhet të njoftohet drejtoria atje ose me E-mail ose me telefon.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, Fatmirja e dha propozimin për mua dhe unë e pranoj pa problem.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, unë pajtohem që në vizitë me shku Kryesuesi, unë dhe Muhameti.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që për vizitë në Qendrën për Punë Sociale me shkuar: Kryesuesi z.Rrahman Kadrija, anëtarët z.Muhamet Ademaj dhe z.Ruzhdi Brahimi.**

z.Muhamet Ademaj; Propozoj që më datën 01.12.2020 (e martë) të shkojmë për vizitë në QPS.

Pika 3

Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të Punës për KPK-në për vitin 2021

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Unë po propozoj që krejt Komiteti të jetë Komision për hartimin e Planit të Punës për KPK-në për vitin 2021.

znj.Fatmire Ferati; Edhe unë mendoj se është mirë që të jetë krejt Komiteti por unë propozoj që paraprakisht ti njoftojmë edhe drejtoritë, për pikat që janë ato kompetente, sepse mund të kenë edhe propozimet e tyre.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; E përkrahu propozimin e Fatmire Feratit.

z.Muhamet Ademaj; Mirë është me i ftuar, drejtorin për shëndetësi, për shërbime publike dhe përgjegjësin e ZKKK-së.

znj.Diarta Vishesella; Përshëndetje, edhe unë e përkrahu propozimin që të ftohen drejtoritë përkatëse.

znj.Fatmire Ferati; Mendoj se do të ishte më mirë që drejtoritë ti thrrasim pasi ta bëjmë draftin final për me dhënë edhe ata ndonjë propozim nëse kanë ose jo.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht zgjodhi Komisionin për hartimin e planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2021 në këtë përbërje:**

1. Rrahman Kadrija – Kryesues i Komitetit,
2. Fatmire Ferati – Zëvendës Kryesuese,
3. Diarta Vishesella – anëtare,
4. Muhamet Ademaj – anëtarë,
5. Xhevahire Ramadani – anëtare,
6. Ruzhdi Brahimi – anëtarë,
7. Arton Demiri - AnëtarArton demiri – Anëtarë.

Mbledhja e parë e Komisionit për hartimin e planit të punës për vitin 2021 do të mbahet më datën 11 Dhjetor 2020 duke filluar në ora 14⁰⁰h.

Pika 4

Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Ibrahim Demirit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit prezantoi informatën në pika kryesore.

Kthimi: Gjatë muajit nëntor nuk ka pasur asnjë kërkesë për kthim.

Riatdhesimi: Gjatë muajit nëntor nuk ka pasur asnjë të riatdhesuar.

Aktivitetet për zbatimin e Planit Komunal të Veprimit për Integrimin e Komuniteteve RAE- 2018-2021: ZKKK-ja ka marrë listën e përfituesve të bursave të nxënësve të shkollës së mesme, nga Ministria e Arsimit ku është konfirmuar se përfitues janë 20 nxënës (19 komuniteti ashkali dhe 1 komuniteti rom). Kemi 5 aplikacione të refuzuara për shkak të suksesit, por pavarësisht , në emër të këtyre nxënësve kemi përcjellur ankesat, në afatin e paraparë, duke i arsyetuar me gjendjen e rëndë të familjeve të këtyre nxënësve. Presim që të shqyrtohen këto ankesa.

Të refuzuara janë aplikacionet e këtyre nxënësve (komuniteti ashkali): 1. Mirsad Abazi-bujqësi, 2. Ernim Jakupi- makineri, 3. Resul Maliqi- bujqësi, 4. Sadullah Bajrami- makineri, 5. Lami Baliu-makineri.

Kemi dorëzuar kërkesa në IOM, GIZ, OSBE, UNMIK, UNICEF, KFOS, Qatar Charity Kosova dhe KFOR-in turk për pajisjen e nxënësve me pajisje elektronike për ndjekjen e mësimin nga shtëpia-AJPED (170 nxënës). Kemi marrë përgjigje nga shumica se kërkesa është duke u shqyrtuar.

Vështrim i përgjithshëm i komuniteteve: Në thirrjen publike për ndarjen e subvencioneve ku kanë aplikuar dy OJQ të komunitetit Ashkali, OJQ- KF”Blindona” – me projektin “Pajisje shkollore për nxënës të SHFML të komunitetit ashkali dhe rom në Komunën e Shtimes” dhe OJQ- “Art Stars Union”- me projektin “Të jetojm shëndetëshem”, tani janë realizuar, sipas projektit.

Për aktivitetin e OJQ “ Blindona “ është angazhuar një staf prej tre personave që kanë punuar në mënyrë vullnetar duke organizuar shpërndarjen e 82 qantave me pajisjeve shkollore (qanta, fletore tri lloje, lapsa, goma, makina, vizore dhe material-lodra për parafillor), përfitues të drejtpërdrejt ishin nxënësit nga qyteti i Shtimes (52 nxënës) në fshatin Davidoc (3nxënës), në fshatin Vojnovc (8 nxënës) dhe fshati Gjurmoc (15 nxënës).

Projektet në terren për komunitetet dhe përfituesit si dhe bashkëpunimi me palët e interesuara-aktivitetet e ndërgjegjësimit publik:

Sa i përket programit të IOM-it, për projekte individuale dhe për projekte (2) për investime në infrastrukturë –kapitale, komuna ka bërë zotimin e mjeteve prej 4280€. IOM-i participon me shumën tjetër të dy projekteve të infrastrukturës-Ndriçim Publik në Gjyrovoc dhe Vojnovc ku shuma e përgjithshme është 18.280€. projekti do të fillojë së realizuari pasi ta zgjedhë IOM-i kontraktorin.

Projektet individuale, përfituesit e zgjedhur, janë në kontakt të drejtpërdrejtë me IOM-in dhe janë në zbatim e sipër.

Ka filluar sot ndërtimi edhe i shtëpisë së 6-të nga MPMS për Elmi Jakupin. Presim që së shpejti të kompletohen edhe 5 shtëpitë e ndërtuara pasi që kemi bërë presion të vazhdueshëm në MPMS.

Çështje të tjera ose aktivitete: Ende nuk ka filluar shpërndarja e pakove ushqimore përmes QPS-së ku do të përfitojnë familjet nga Lista e asistencës sociale, por edhe familje të tjera që do t'i rekomandojë ZKKK-ja.

Buxheti:

ZKKK-ja gjatë këtij muaji, nga subvencionet ka realizuar 4 kërkesa: Emran Jakupi 400€-qira për strehim. Rrahim Maliqi-100€-shpenzime mjekësore. Xhemajl Shabani100€-shpenzime mjekësore. Xhemajl Ilazi 250€-shpenzime mjekësore për bashkëshorten.

Kemi edhe 6 kërkesa për të cilat nuk kemi tani për tani buxhet. Presim që të na bëhet edhe një alokim, për të cilin kemi bërë kërkesë te ZKF.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, për këto gjashtë kërkesat që u përmenden në informatë, a i dini emrat e tyre, sepse kur bëhet kërkesa duhet me i ditë edhe emrat e atyre.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; U përgjigj në pyetje, po nuk u kuptua për shkak të dialogut në mes Ibrahim Demirit, Ruzhdi Brahimit e Rrahman Kadrija, lidhur me pagesat e qirave të disa pjestarëve të komunitetit pakicë si dhe ndërtimin e shtëpive.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, e falënderoj z.Ibrahim Demirin, edhe z.Rrahman Kadrija, që kanë ndihmuar për me e përfunduar një herë e përgjithmonë rastin e Elmi Jakupit, për tu bërë me shtëpi banimi.

z.Muhamet Ademaj; E falënderojmë Ibrahimin për Informatën. Na gëzon fakti që sot edhe shtëpia e gjashtë për Elmi Jakupin ka filluar të ndërtohet. Po ashtu janë ndarë edhe 19 bursa për nxënës të komunitetit pakicë. Është mirë që Zyra me ndihmuar në shkollimin e tyre sipas mundësive financiare, sepse këta pastaj do të kontribuojnë në zhvillimin dhe emancipimin e shoqërisë. E përmendi Ibrahim buxhetin, por unë nuk e di saktë edhe sa mjete kan mbetur nga ato që janë ndarë në shumën prej 22,419.00€ për ZKKK-në. Për shkak të pandemisë mësimi po mbahet on-line, kështu që në rast se ka mjete kishte qenë mirë me ndihmuar me ndonjë Laptop.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Sa i përket këtyre pesë nxënësve që nuk kanë marrë bursa, ne e kemi paraqitur atje një ankesë, dhe po presim e po shpresojmë se ankesa do të shqyrtohet dhe do të vendoset pozitivisht, edhe për këto pes raste.

Pika 5


Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi që diskutime nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 14.58 h.

Procesmbajtës

Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit

Rrahman Kadrija

